



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 39  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302  
Prishtinë, më 28 shtator 2016, në orën 13:00

**P R O C E S V E R B A L**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu, Ali Berisha dhe Adem Hoxha.

**Munguan:** Mirjeta Kalludra dhe Shukrije Bytyçi.

**Të ftuar:** Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Ramadan Halimi, këshilltar në MSH; Hysni Bajrami, Musa Rexhaj, Arsim Qavderbasha,, Bekim Fusha- MSH; Eugen Cakolli –KDI dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** fillimisht Hatim Baxhaku, nënkryetar i Komisionit dhe mandej Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.9.2016
3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:
  - Funkcionalizimi i odave të profesionistëve shëndetësorë;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;
5. Të ndryshme.

**Nënkryetari i Komisionit, Hatim Baxhaku,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.9.2016**

**Nënkryetari** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.9.2016, me plotësim nga deputetja Besa Baftiu, lidhur me plotësimin e planit të punës për këtë sesion.

### **3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrrahmani:**

#### **- Funkcionalizimi i odave të profesionistëve shëndetësorë**

**Nënkryetari** – Fillimisht, më lejoni të falënderojmë ministrin, z. Rrahmani, si dhe stafin tjetër të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët iu kanë përgjigjur ftesës së Komisionit për të diskutuar lidhur me funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Atëherë, sa për njoftim, ne si Komision parlamentar kemi realizuar një takim me kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë, ku ishte një qëndrim i të gjithë kryetarëve se kanë pengesa të mëdha nga ministria për funksionalizimin e odave, e sidomos vërejtjet e tyre ishin se më datën 30.6.2016, ka kaluar afati ligjor kur odat duhet të pavarësoheshin edhe me kompetenca, edhe në aspektin buxhetor. Pra, kërkesa kryesore e tyre ishte pavarësimi buxhetor, si dhe bartja e kompetencave, andaj Komisioni ka vendosur që t'ju ftojë dhe nga afër të njoftohet lidhur me funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Urdhëroni z. ministër!

**Imet Rrahmani** – Faleminderit z. kryesues!

Të nderuar deputetë! Sinqerisht, unë jam i kënaqur që sot jam këtu së bashku me ju, që të kemi mundësi të diskutojmë lidhur me zbatimin e ligjit, i cili është pjesë e reformës së sistemit tonë shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë ka punuar konform ligjit, me kujdesin më të madh dhe është munduar ta zbatojë atë. Pra, kemi të bëjmë me kompetenca të deleguara dhe me funksionet publike, të cilat kanë një impakt të madh edhe në sistemin shëndetësor, edhe në jetën e përgjithshme dhe të cilat natyrisht bartin përgjegjësi. Duke u nisur nga ky fakt, Ministria e Shëndetësisë, prej themelimit të odës së parë, e cila ka ndodhur më 24 shtator 2013, pra Oda e Mjekëve, e deri më sot, me kujdesin më të madh po ecim tutje në zbatimin e ligjit dhe bartjen e kompetencave të deleguara te odat, që nënkupton që asnjëherë, në asnjë rrethanë, Ministrisë së Shëndetësisë nuk i largohet përgjegjësia e mbikëqyrjes së këtyre funksioneve, kompetencave të deleguara te odat. Oda e parë është themeluar më 24 shtator 2013 dhe tash oda e fundit që është themeluar, është Oda e Fizioterapeutëve, më 8 korrik 2015. Brenda kësaj periudhe janë mbajtur 15 kuvende zgjedhore, të cilat janë mbështetur gjithmonë nga Ministria e Shëndetësisë (MSH). Kanë qenë kuvende shumë transparente demokratike, me pjesëmarrjen e të gjithë punëtorëve shëndetësorë, me të drejtë kandidimi dhe të drejtë zgjedhjeje dhe kanë dalë organet kompetente, ku asnjë kuvend nuk është

kontestuar. Ministria e Shëndetësisë (MSH), ka mbështetur odat në vazhdimësi, në hartimin e akteve normative të domosdoshme për funksionalizimin e odave. Po ashtu, MSH ka qenë bartëse kryesore e hartimit të këtyre akteve. Përkundër faktit që odat kanë pasur kompetenca dhe obligime, që vetë të angazhohen më intensivisht dhe t'i hartojnë këto dokumente. Janë hartuar statutet, kodi i etikës profesionale rregullorja për edukim të vazhduar profesional, rregullorja për etikë profesionale, rregullorja për licencim, vendimi i përkohshëm për të hyrat e odës. Me marrjen e mandatit, kemi pasur një buxhet të planifikuar për odat, dhe duke parë që disa oda janë aktive, por këtu kemi pasur edhe odë që qenë tërësisht pasive, si dhe kemi dashur që të bëjmë një shpërndarje më të drejtë të atij buxheti që ka qenë, i cili ka qenë i planifikuar për odat. Ne kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e odave, kemi bërë një ndarje sipas marrëveshjes në përqindje (%) për odat, që ka qenë miratim i katër odave, deri atëherë të themeluara, me përjashtim të Odës së Fizioterapeutëve. Odat e kanë shfrytëzuar atë buxhet sipas marrëveshjes, që jemi pajtuar të ndahet dhe askush nga Ministria e Shëndetësisë nuk i ka penguar në shfrytëzimin e atij buxheti. Sa i përket kërkesave të odave, në këtë rast, duhet të theksoj se nuk kemi pasur asnjë projekt të shkruar, pra në letër, në MSH, për funksionalizimin e odave. Pra, të gjitha kërkesat, deri më sot, të odave janë miratuar nga ministri i MSH-së, në funksion të funksionalizimit të odave. Për këtë çështje do t'i shihni edhe materialet që ua kemi sjellë dhe do t'i shikoni se si i kanë shfrytëzuar këto mjete. Pra, do t'i shikoni se sa kërkesa i kanë bërë dhe çfarë kërkesash i kanë sjellë. Pra, vetë do t'i shikoni se a kanë bërë kërkesa për zhvillime programore apo kanë bërë kërkesa për hartimin e dokumenteve, që janë në funksion të funksionalizimit të odave apo kanë qenë kryesisht udhëtime studimore dhe zyrtare. Pra, të gjitha këto i keni të paraqitura këtu në materiale. Ne i kemi mbajtur disa punëtori me përfaqësuesit e odave për zbatimin e ligjit, dhe në punëtorinë e fundit që është mbajtur në Durrës, të gjitha odat që janë deklaruar se janë të gatshme për marrjen e kompetencave të caktuara, atyre ua kemi bartur kompetencat më 1 korrik 2016. Fatkeqësisht, Oda e Mjekëve nuk ka qenë e gatshme që të dëshmojë se ka hartuar të gjitha dokumentet e nevojshme, me të cilat do të kishte qenë e sigurt në marrjen e këtyre kompetencave, që ua kemi bartur katër odave tjera, edhe pse është themeluar e para. Ne ua kemi sjellë procesverbalin, po ashtu e kemi edhe me audio, me zë, nëse e dëshironi, pra deklarin e përfaqësuesve të odave, se a janë të gatshëm për marrjen e kompetencave. Para qershorit, e kemi marrë vendim që të gjitha taksat në kompetencë të odave, të bartën në xhirollogari të odave. Pra, kemi kërkuar në Ministrinë e Financave, që të hapen nën kodet për odat dhe të gjitha taksat që parashihen për secilën odë, të barten në nën kodin e tyre dhe ata do të shohin se sa kanë buxhet, secila. Me ligjin për rishikimin e buxhetit, të gjitha mjetet nga taksat për oda, barten në thesar, gjë që nënkupton që odat mund ta shfrytëzojnë atë buxhet, konform miratimit që e bën ministri i MSH-së dhe konform kërkesave të argumentuara dhe legjitime, dhe në fund të vitit, buxheti që mbetet do t'u bartet në xhirollogari të odave, më 1 janar 2017, ku odat do të jenë plotësisht të pavarura nga aspekti financiar dhe do të operojnë, varësisht mundësive të tyre financiare që i kanë. Ata do të jenë përgjegjës edhe për menaxhimin e drejtë të atij buxheti, natyrisht do t'i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e parasë publike. Ministria e Shëndetësisë, absolut nuk është kundër funksionalizimit të odave, pra nuk është kundër bartjes së kompetencave, se lehtësohet puna në MSH dhe në jemi të kujdesshëm që këto kompetenca publike të bartën në duar të sigurta, sepse kemi të bëjmë me procese shumë të ndjeshme profesionale, me edukimin e vazhdueshëm profesional, me problemet etike me licencimin dhe rilicencimin, me planifikimin dhe organizimin e specializimeve. Ne, ende s'kemi asnjë kërkesë, asnjë projekt apo dokument ku parashihet plani i menaxhimit të buxhetit nga odat. Pra, nuk kemi asnjë dokument nga

odat, ku prezantohet plani sesi do të vazhdohet tutje në edukim profesional apo dokumente që kanë hartuar regjistra të punëtorëve shëndetësorë dhe kanë planifikuar nevojat e sistemit tonë shëndetësor për specializimet. Ne kemi kërkuar nga odat që t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre në trupat profesionale në MSH, që nga afër të shohin sesi veprohet në procese të tilla, të krijojnë përvojën e tyre, dhe me rastin e bartjes së kompetencave, të jenë të përgatitur. Disa oda i kanë deleguar disa të tjerë më rezistencë, por në përgjithësi puna ka ecur mirë. Ne, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike, dhe pas konsultimeve të shumta dhe mbështetjes që na ka ofruar edhe kryeministri, kemi arritur që t'ju sigurojmë odave hapësirat e punës. Hapësirat janë siguruar në hapësirat ku ka vepruar Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Pra, odat i kanë hapësirat, ndërsa ne jemi kujdesur që t'i pajisim nga aspekti teknik dhe brenda tri viteve, ne mund të konstatojmë se kemi ecur shumë mirë me zbatimin e këtij ligji. Këtu me mua janë edhe ekspertët, të cilët kanë qenë bartës të proceseve dhe të hartimit të dokumenteve për oda, që do të na japin sqarime shtesë, nëse do të këtë nevojë. Ju faleminderit!

Mbas deklarimit të ministrit, në pjesën e parë, mbledhjen e kryesoi më pas kryetarja e Komisionit, Flora Brovina.

**Kryetarja** – Kërkoj falje për vonesën time, pasi që isha në një takim.

Ju faleminderit që po i përgjigjeni ftesës sonë, në vazhdimësi, për raportim në Komision. Ka qenë kërkesë e gjithë anëtarëve të Komisionit, që t'ju ftojme dhe të diskutojmë për funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Ju iu keni bërë ftesë të gjithë profesionistëve shëndetësorë, që të aplikojnë për rilicencimin e tyre. Kjo kompetencë, është e paraparë me ligj që të jetë kompetencë e odave, mirëpo ndoshta mosfunksionimi i odave iu ka detyruar që të veproni, si ministri. Këto shpjegime na duhen neve, si Komision. Urdhëroni z. Ministër!

**Imet Rrahmani** – Më lejoni të japë një sqarim shtesë lidhur me rilicencimin. Po e ritheksoj se asnjëherë odat nuk kanë sjellë asnjë dokument apo plan veprimi sesi do t'i menaxhojnë këto procese. Ju e dini që licenca e parë është dhënë më 2001 dhe në vitin 2006 ka skaduar licenca e parë. Pra, nga viti 2006 e deri më sot, kemi pasur rilicencime, me vendim të ministrit të MSH-së. Pra, mund të themi se kemi pasur rilicencime puro politike. Një vendim i ministrit i ka rilicencuar të gjithë punëtorët shëndetësorë, pra ua ka vazhduar validitetin e licencave. Duke e parë situatën se odat nuk janë të gatshme që shumë shpejt të marrin këtë përgjegjësi, ne e kemi diskutuar brenda ministrisë, me ekspertë të fushës dhe Bordin për Licencimin dhe kemi ardhur në përfundim se kemi mundësi që të fillojmë me këtë proces dhe absolutisht nuk nënkupton që si proces nuk do t'i bartet odave. Ne, me këtë veprim, kemi dashur që të bindim edhe opinionin publik, se punëtorët shëndetësorë, edhe përkundër vështirësive, kanë gjetur kohë për edukim të vazhdueshëm për pjesëmarrje nëpër konferenca, kongrese, mbahen takime, konsultime profesionale dhe i kemi inkurajuar edhe menaxherët që t'i akreditojnë këto aktivitete dhe të mblidhen pikët, që punëtorët shëndetësorë të licencohen apo rilicencohen me standarde, pra me kritere. Ju jeni në dijeni se punëtorët shëndetësorë kanë shkuar dhe janë duke shkuar jashtë për të punuar. Ata kanë bërë kërkesa të ndryshme për vazhdimin e validitetit të licencës, me vendim nga ana e ministrit të MSH-së, por nuk është valid dhe nuk pranohet askund. Ne e kemi filluar procesin dhe kemi një plan dinamik të zhvillimit të këtij procesi. Ne e kemi bartur tashmë këtë kompetencë tek odat dhe kjo kompetencë, deri në fund të vitit, do të ushtrohet bashkë me odat. Unë iu kam sjellë dëshmi se si

Oda e Infermierëve, me azhuritetin që ka treguar në punën e vet, është duke ushtruar këtë kompetencë. Pra, më 1 janar 2017, atyre do t'ju bartet kompetenca e plotë dhe MSH nuk do të ketë nevojë të merret me licencimin apo rilicencimin e tyre. Ne ju kemi sjellë edhe kopje të licencës, ku kryetari i Odës së Infermierëve, z. Rrustemaj është bashkë nënshkrues i licencës, së bashku me kryetarin e Bordit për Licencim dhe ministrin e Shëndetësisë. Pra, kjo është dëshmi se ata janë duke e ushtruar këtë kompetencë dhe janë duke e përkrahur këtë proces, të cilin e kemi nisur para disa kohësh.

**Kryetarja** – Ka qenë një takim mjaft i gjatë, me kryetarët e odave, dhe sigurisht, edhe deputetët tjerë kanë diçka për të shtuar apo pyetur, lidhur me odat e profesionistëve shëndetësorë. Urdhëroni Besa!

**Besa Baftiu** – Ne dëgjuam ministrin, mirëpo siç e dini, i kemi dëgjuar paraprakisht edhe kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë. Në bazë të asaj që dëgjuam nga ju ministër dhe në bazë të asaj që kemi dëgjuar nga kryetarët e odave, është me të vërtetë një kundërthënie e madhe. Në bazë të asaj që kanë deklaruar kryetarët e odave, nëse mund të themi emëruesi i përbashkët është se Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht ministri, nuk po e zbaton Ligjin për odat. Unë, si anëtare e Komisionit, kam kërkuar që, sipas planit të punës, të kemi një debat publik. Do të ishte më mirë që të ballafaqohemi, pra ministria, kryetarët e odave, komisioni, ekspertë të fushave të ndryshme. Pra, të ballafaqohemi të gjithë së bashku dhe të dimë se ku dhe kush është fajtori. Ju thatë se nuk keni kërkesë, mirëpo kryetarja e Odës së Mjekëve ka potencuar se ka bërë 50 kërkesa në Ministrinë e Shëndetësisë dhe këto kërkesa janë injoruar nga ministri i MSH-së. Po ashtu, kanë kërkuar takim dhe janë injoruar, sipas saj, ka pasur edhe kërcënime. Pra, këto që po i themi, janë sipas deklarimit të saj. Sipas saj, deklaratën që e ka dhënë për media për mosfunksionalizimin e Odës së Mjekëve, ministria, në ueb faqen e saj, e ka bërë një shkrim dhe përmes këtij shkrimi e keni kërcënuar dhe e keni fyer personalitetin e saj. Pra, unë e kam kërkuar dhe do të vazhdojë të kërkojë një debat, ku do të jeni prezentë të gjithë. Ligji për odat ka kaluar në vitin 2013 dhe po bëhen tri vjet, që nuk po zbatohet. Ju thatë se keni filluar që të punoni në atë drejtim. E potencuat se më 30 qershor 2016, katër odat i kanë marrë kompetencat e licencimit. Sipas tyre, nuk ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim, kurse ju potencuat se në bashkëpunim me kryetarin e Odës së Infermierisë, keni filluar që të bëni rilicencimin.

(Ndërhyrje e ministrit) **Imet Rrahmani** – Ku i keni dëshmitë për këtë gjë?

**Besa Baftiu** – Ne, si komision, kemi qenë të shqetësuar për atë që kemi dëgjuar nga kryetarët e odave. Ju faleminderit!

**Kryetarja** – Neve, si ligjvënës, na intereson se problemi i mosfunksionimit të odave, a ekziston tek ligji apo kemi ndonjë problem apo pengese tjetër, në këtë rast, tek personat që udhëheqin. Mirëpo, ata kanë dëshmi që janë zgjedhur me vota nga kolegët e tyre. Urdhëroni z. ministër!

**Imet Rrahmani** – Ne, si ministri, iu kemi përgjigjur ftesave tuaja dhe mund të na vizitoni. Pra, iu kemi ofruar gatishmëri për bashkëpunim, prej fillimit. Ato që i potencoi deputetja, znj. Baftiu, që sipas saj, i ka thënë kryetarja e Odës së Mjekëve, janë plotësisht të pabaza. Atëherë, më lejoni t'ua

prezantoj: më datë 13 korrik 2015, takim me kryetarët e odave, pas dhjetë minutave të takimit, kryetarja e Odës së Mjekëve e lëshoi takimin, kurse katër kryetarët e odave tjera, kanë qëndruar në takim, nuk kemi ndonjë arsye. Më 6 tetor, Ditën e Shëndetësisë Austriako – Kosovare, i kemi ftuar të gjitha odat, që të marrin pjesë. Pra, nuk e kemi pasur për obligim dhe i kemi ftuar, ndërsa iu kemi thënë, ejani dëshmoni se jeni faktorë të rëndësishëm. Forumi Kosovaro – Kroat për kujdesin shëndetësor, prapë i kemi ftuar. Në takimin koordinues me komitetin e donatorëve, i kemi ftuar. Me 29 janar 2016, takim me kryetarë dhe nënkryetarë të odave, ka munguar kryetarja e Odës së Mjekëve. Më 30 janar, erdhi kërkesa për takim individualisht dhe e kam refuzuar, pasi që e kam pasur agjendën time. Më 19 dhe 20 shkurt 2016, komiteti koordinues, punësoria në Istog, pra me odat për ndarjen e buxhetit, siç e potencuam më lart, për vazhdim më tej dhe për të prezantuar dokumentet, të cilat i kanë përgatitur dhe që duhet të hartohen, për të cilat duhet përkrahja më e madhe e MSH-së, Oda e Mjekëve të Kosovës nuk është pjesëmarrëse, kurse odat tjera morën pjesë. Më 22 – 24 prill 2016, komiteti koordinues, punësoria me odat në Durrës, Zehadin Gashi, kryetar, Dafina Ibrahim, kryetare, Naser Rustemaj, kryetar, Arben Grazhdani, përfaqësues, nënkryetar, i cili ka dhënë dorëheqje, Blerim Kamberi, Oda e Stomatologëve, përfaqësues. Më 12 qershor 2016, komiteti koordinues, punësoria në Durrës, po i citoj të gjithë: Dafina Ibrahim, kryetare, Naser Rustemaj, kryetar, Islam Usaj, përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës. Pra, në këtë punëtori, ku e kemi procesverbalin edhe incizimin, ku janë deklaruar se a mund apo nuk mund t'i marrin kompetencat. Unë po ua citoj procesverbalin, Islam Usaj, përfaqësues i Odës së Mjekëve, citoj: “Brenda periudhës korrik-shtator, Oda e Mjekëve do të mbajë kuvendin dhe do t'i miratojë aktet normative, të cilat iu mungojnë”. Këto akte normative, odat tjera, edhe pse më vonë janë themeluar, i kanë miratuar, kurse Oda e Mjekëve, prej 10 akteve, vetëm 4 prej tyre i ka pasur. Ministria ka shprehur gatishmëri dhe kemi marrë përgjegjësi që t'i ndihmojmë odës, pra edhe t'i miratojnë. I kanë punuar disa drafte dhe nuk kanë qenë konform ligjeve dhe i kemi dërguar në Zyrën Ligjore të MSH-së, ndërsa e kemi konsultuar edhe Zyrën Ligjore të Kryeministrit. Pra, i kemi kthyer me komente që t'i inkorporojnë. Ne, më 26 shtator 2016, ua kemi kthyer dhe u kemi kërkuar që të mbajnë kuvendin dhe t'i miratojnë, si dhe të na njoftojnë që i kanë miratuar, ndërsa ne ua bartim kompetencat. Pra, kjo çështje është personalizuar dhe politizuar tej mase, karshi Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht ministrit. Ju njoftoj se ka pasur edhe komunikim jo-korrekt edhe me Odën e Mjekëve të Gjermanisë, ku keni edhe dëshminë, që ua dorëzova me dokumente. Oda e Mjekëve të Gjermanisë, të cilët na janë drejtuar me një shkresë dhe janë detyruar të dërgojnë një përfaqësues të tyre, për të parë nga afër se çfarë po ndodh. Pra, keni dëshmi se si e ka lajthitur Odën e Mjekëve të Gjermanisë. Më duket, më datë 28 prill, ka bërë kërkesë kryetarja e Odës së Mjekëve, për të marrë pjesë në sesionin 119 të Odës së Mjekëve të Gjermanisë, në të njëjtën ditë ua kam aprovuar. Në një përbërje shumë reprezentative, ne kemi qenë mysafir nderi. Në Odën e Mjekëve të Gjermanisë, jemi takuar edhe me ministrin e Shëndetësisë të Gjermanisë, ku kemi qenë mysafirë nderi dhe jemi përshëndetur si përfaqësues të Republikës së Kosovës. Aty keni një dëshmi, ku na vjen një shqetësim i Odës së Mjekëve të Gjermanisë, se ne nuk ia kemi lejuar pjesëmarrjen kryetares së Odës së Mjekëve, në këtë sesion. Kur i kemi përcjellë dëshminë se ne ia kemi lejuar pjesëmarrjen, ata na kërkuar falje. Më 2 tetor 2015, iu kemi drejtuar kryetares së Odës së Mjekëve dhe anëtarëve të kuvendit të odës, ku kemi ngritur shqetësimet tona për mosefikasitetin e hapësirës për funksionalizim të Odës së Mjekëve. Pika 1, të cilën më vonë e konfirmon edhe vetë kryetarja e Odës së Mjekëve. Statutin që e kanë miratuar, ka qenë i miratuar në mënyrë të kundërligjshme. Pra, është rimiratuar statuti, ndërsa ne iu kemi adresuar më 2 tetor 2015, kurse ata, më 22 tetor 2015, e

kanë rimiratuat statutin, me pjesëmarrje masive, ka pasur kuorum, 93 prezentë. Kryetarja e odës, më 22 janar na dërgoi konfirmimin se ne e kemi rimiratuat statutin konform ligjit. Pra, statuti dhe krejt aktet që kanë qenë të miratuara deri atëherë, kanë qenë jo- ligjore. Përfaqësuesit që kemi kërkuar, që të jenë pjesë në bordet e MSH-së, të gjitha odat tjera i kanë dërguar, vetëm Oda e Mjekëve s'i ka dërguar. Po ashtu, i kemi shprehur shqetësimin se më shumë se një vit organet e odës nuk janë takuar as këshilli drejtues, as organet tjera. Arsyetimi ka qenë se nuk po marrin pagë dhe pa paga nuk punojnë. Është një vendim i ish-ministrit, që pagat e kryetarëve të odës, të jenë 1000 € (një mijë euro). Po ashtu, është edhe një bazë ligjore, ku thotë se ata duhet të punojnë vetëm në odë, eventualisht në proces arsimor, me përjashtim të kryetarit të Odës së Farmacistëve, të tjerët asnjëri nuk ka deklaruar apo dëshmuar që e ka lëshuar vendin e punës dhe tash janë vetëm kryetarë të odave. Kryetari i Odës së Farmacistëve ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë pagat e tij, si kryetar i odës. Kurse, sa i përket asaj që ka thënë se e kemi kërcënuar, nuk është e vërtetë se e kemi kërcënuar. Këto janë disa sqarime, mirëpo shumicën prej tyre, edhe më gjerësisht, i keni edhe në materialet që ua dorëzuam. Ju faleminderit!

**Kryetarja** – Shfrytëzoj rastin t'i uroj mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit, deputetit z. Ali Berisha, i cili do të zëvendësojë deputeten, znj. Time Kadrijaj. Urdhëroni z. Berisha !

**Ali Berisha** – Ju faleminderit kryetare! Përshëndetje ministër dhe ju përfaqësues të ministrisë, të nderuar kolegë deputetë!

Është një fat i madh që kemi një ligj që është miratuat gati që katër vite, i cili fatkeqësisht nuk është duke u zbatuar. Nuk duhet të gjuajmë fajin herë te njëra palë, herë te tjetra, sepse bartës i funksionit apo i të gjitha atyre që bëhen në sektorin e shëndetësisë, është pra Ministria e Shëndetësisë. Ministria, edhe nëse ka pasur pengesa deri më tani, ka qenë dashur të japë më shumë efekt në zgjidhjen problemit. Odat janë të domosdoshme dhe funksionalizimi i tyre është i domosdoshëm. Ne e dimë që kemi pasur oda të profesionistëve shëndetësorë, mirëpo për punëtorët shëndetësorë, Oda e Mjekëve është kryesorja. Kjo odë duhet të fillojë të funksionojë. Imazhi i doktorëve është i nëpërkëmbur gjithkrah. Kemi shumë doktorë nëpër gjykime, diku me të drejtë, diku pa të drejtë.

- A kemi mekanizëm tjetër, që në një formë t'i mbrojnë këta doktorë, që shpeshherë padrejtësisht janë të atakuar? Ministria duhet që imazhin e punëtorit shëndetësor të mundohet ta mbrojë, aty ku ka të drejtë. Odat janë një mekanizëm, komisionet e odave, si komisioni etik, prokurori i odave, janë më kompetentë se çdo mekanizëm tjetër në Kosovë, për të përcaktuar diçka se kur është indikacion për një intervenim apo jo. Pra, ne duhet t'i shfrytëzojmë ato, pasi që me këta mekanizma e mbrojmë punëtorin shëndetësor, pra kur nuk gabon, e mbrojmë edhe pacientin. Në këtë rast, edhe pacienti ndihet më mirë, kur e di se punëtori shëndetësor i ka kryer të gjitha veprimet që është dashur të kryhen. MSH duhet të gjejë mekanizma, që sa më shpejtë të bëjë bartjen e kompetencave, si dhe funksionalizimin e të gjitha odave. Andaj, kërkojmë nga ju ministër, që të gjitha ato që janë kontestuese apo joligjore, që t'i eliminoni dhe të filloni me zbatimin e ligjit në tërësi për odat e profesionistëve. Pra, me rëndësi të veçantë, është që Oda e Mjekëve të Kosovës, të fillojë të funksionojë. Ju faleminderit!

**Kryetarja** – U shtruan shumë çështje apo probleme, andaj duhet të gjejmë një zgjidhje në tejkalimin e tyre dhe funksionalizimin e plotë të të gjitha odave. Urdhëroni z. Hysni Bajrami, nëse keni diçka për të shtuar.

**Hysni Bajrami** – Ju faleminderit kryetare! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komisionit parlamentar. Është një ligj, për të cilin mund të themi se është mjaft i avancuar. Kur ka filluar që të diskutohet për organizimin e odave të profesionisteve shëndetësorë, në këtë ligj është punuar për gjashtë muaj në komision parlamentar. Pra, ka pasur diskutime,, ide të ndryshme, lidhur me prokurorin e odave, gjykatën e odës etj. Asnjë odë e mjekëve në Evropë nuk ka kompetenca më të afirmuara se Oda e Mjekëve në Kosovë. Po ashtu, kemi një mbikëqyrje e cila është liberale nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Vendet e rajonit, kanë Ministrinë e Shëndetësisë, si shkallë të dytë. Ne e kemi hequr dhe e kemi bartur dyshkallëshin tek odat. Pra, janë ndarë në kompetenca të deleguara dhe kompetencat vetjake, në këtë rast odat janë krejtësisht të pavarura, të cilat mundet t'i ushtrojë pa asnjë pengesë nga MSH-ja. Pra, në këtë rast, asnjë kompetencë vetjake nuk e kanë ushtruar, nuk kanë asnjë program zhvillimor. Le të dalë një përfaqësues i një ode dhe le të thotë se e ka miratuar vetë, vetëm një akt, pa ndihmën e ministrisë, pra përveç akteve që ju kemi përgatitur, asnjë akt tjetër nuk e kanë nxjerrë. Sipas praktikave të vendeve të ndryshme të Evropës, funksionalizimi i plotë i një ode, kërkon një periudhe pesëvjeçare. Licencimi komplet është nën ombrellën e odave, të gjitha mjetet që vijnë nga licencimi shkojnë në kodin ekonomik të odave. Të gjitha odat i kanë përfaqësuesit e tyre në përgatitjet teknike, që me një janar 2017, të bartën të gjitha kompetencat komplet tek odat. Së fundi, është hapur një konkurs për përzgjedhjen e nga një asistenti për secilën odë. Asistentët administrativë do të paguhën nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, përzgjedhja do të behët nga kryetari i odës. Kurse, nga një janari 2017, do të kemi shërbimin administrativ, i cili do të kryejë shërbime në baza kontraktuale për të gjitha odat.

**Kryetarja** – Kur është fjala për administratën e odave, e kuptuam që administrata ndodhet në Ministrinë e Shëndetësisë. Pra, në të vërtetë, nuk është bartur tek odat. Neve na intereson se a ka nevojë për intervenim, pra ndryshim të ligjit.

**Hysni Bajrami** – Sigurisht që ka nevojë për plotësim apo ndryshim të ligjit. Ne i kemi disa vërejtje lidhur me këtë proces, nga ata që na kanë ndihmuar dhe mbikëqyrur në këtë proces, sepse Oda e Mjekëve është pjesë e asociacionit mjekësor të krejt botës. Oda Federale Gjermane, si sponsor i odave mjekësore, na kanë thënë se me të vërtetë keni një ligj shumë të avancuar dhe shumë shpejt po mundoheni që të përmbyllni këtë proces. Ju faleminderit!

**Kryetarja** – Urdhëroni z. Ministër, nëse keni diçka për të shtuar lidhur me çështjet që u diskutuan!

**Imet Rrahmani** – Vetëm desha t'i jap disa argumente, sepse nuk qëndron problemi që janë bërë shumë kërkesa nga Oda e Mjekëve dhe janë refuzuar. Po ua lexoj vetëm disa shpenzime të buxhetit të odave për vitin 2015 dhe 2016. Më 28 janar 2016, i lejohen Zylfie Hundozi 1.669 euro për mbajtjen e Kuvendit të VI të Odës së Mjekëve; më 1.8.2016, i lejohet shuma prej 1.590 për rezervim të sallës dhe dreka për mbajtjen e kuvendit të odës; më 3.8.2016, i lejohen 960 euro për iniciimin e procedurave për ueb faqe, ku jemi duke ua ofruar edhe një asistencë profesionale. Këto janë për vitin 2016, por po ju njoftoj edhe për vitin 2015. Më 27.5.2015, Zylfie Hundozi, Nurten Zhuri, biletë udhëtimi 669 euro; më 27.5.2015, Zylfie Hundozi, Nurten Zhuri, biletë udhëtimi për në Gjermani, 358 euro; më 28.4.2015, Zylfie Hundozi, biletë udhëtimi në Kroaci 961 euro; më 28.4.2015, Nurten Zhuri, biletë udhëtimi në Kroaci 961 euro; më 6.5.2015, Zylfie Hundozi, biletë udhëtimi për në Gjermani 321euro; më 7.9.2015, Zylfie Hundozi, udhëtim zyrtar në Shqipëri 495



euro; më 7.9.2015, Ukshin Ismajli, udhëtim zyrtar në Shqipëri 495 euro; më 7.9.2015, Arben Gozhani, udhëtim zyrtar në Shqipëri 495 euro; më 7.9.2015, Shemsedin Sadiku, udhëtim zyrtar në Shqipëri 545 euro; më 7.9.2015, Rrezart Halimi, udhëtim zyrtar në Shqipëri 545 euro; më 3.11.2015, Arben Grazhdani, udhëtim zyrtar në Angli 2.230 euro; më 3.11.2015, Rrezart Halimi, udhëtim zyrtar në Angli 2.230 euro. I vetmi refuzim që është bërë, i është bërë Odës së Farmacistëve, që kanë kërkuar të marrin pjesë në një kongres, ku vlera ka qenë rreth 28 mijë euro, e cila ka qenë e lartë.

**Kryetarja** – Me Ligjin për shëndetësi, është menduar një reformë, që nënkupton edhe decentralizim, por që decentralizimi i ka shkaktuar disa vështirësi, Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe atyre që i kanë marrë kompetencat. Pra, ky decentralizim, më duket është shumë i dyshimtë dhe më shumë duket si centralizim. Nga ministria, këtë centralizim, e bartëm te SHSKUK. Gjithashtu, tani edhe kompetencat e odave, të barten pa qenë të gatshëm. Pra, këto pengesa, a janë defekte të ligjit apo ndonjë çështje tjetër?

**Besa Baftiu** – Deri tani, debatuar vetëm për kryetaren e odave të mjekëve, por nga takimi që patëm edhe me kryetarët e odave tjera, të gjithë ankoreshin se problemet janë te Ministria e Shëndetësisë. Kryetari i Odës së Stomatologëve, ka thënë se Ministria e Shëndetësisë nuk di dhe nuk do që t'i zgjidhë problemet. Secili nga kryetarët e odave tjera, është pajtuar me ato çka ka thënë kryetarja e Odës së Mjekëve. Kryetari i Odës së Farmacistëve, ka thënë se ne i kemi përmbushur të gjitha kërkesat që i ka parashtruar Ministria e Shëndetësisë, mirëpo pa mjete nuk mund të fillojmë t'i ushtrojmë kompetencat, prandaj kërkojnë ndihmën tonë. Nëse vetëm njëri nga kryetarët e odave ankohet, ne e kishim ditur që problemi ndoshta nuk është te Ministria e Shëndetësisë, por të gjithë kryetarët e odave, janë ankuar në Ministrinë e Shëndetësisë. Mundësia më e mirë është që të diskutojmë në një tryezë dhe të ballafaqohemi të gjithë së bashku.

**Imet Rrahmani** – Deklarimet politike nuk i kisha komentuar. -A dimë a nuk po duam? E kuptoj që për shkak të mungesës së përvojës nuk e dimë se çfarë kompetenca dhe si duhet të silltet oda, përballë Ministrisë së Shëndetësisë. Ne duhet të kemi një klimë partneriteti, sepse odat më tepër po luajnë një rol sindikal. Unë nuk po debatoj, por ju kam sjellë fakte për të gjitha punët që janë kryer dhe nuk mund të mohohen. Oda e Infermierëve është duke ushtruar një kompetencë të licencimit dhe janë për çdo lëvdatë. Ne kemi hartuar shumë dokumente dhe rregullore për funksionalizim të odave dhe ua kemi dërguar që t'i miratojnë. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë. Rilicencimin e kemi filluar si mundësi të krijimit të buxhetit për odat. Por, t'u jap edhe disa shembuj: nëse oda merr vendim për në revokim të licencës, ndërsa gjykata vendos në favor të palës, a ka mundësi oda ta kompensojë palën? Kemi frikë që edhe më 1 janar 2017, ne do t'jua delegojmë kompetencat, por ata nuk do të jenë të gatshëm t'i ushtrojnë.

**Ali Berisha** – Shpeshherë kemi ligje të mira, por në zbatim po hasim në pengesa. Edhe ky ligj, nëse mendoni që ka kompetenca më shumë, më mirë është të rishikohet, sesa të mos zbatohet. Ne jemi trup që e monitorojmë Ministrinë e Shëndetësisë dhe nuk kemi mekanizëm, që secili institucion apo punëtor shëndetësor të na raportojë. Dobësitë në sistemin shëndetësor duhet t'i bartë dhe t'i raportojë Ministria e Shëndetësisë, pra duhet edhe t'i zgjidhni, jeni kompetentë. Edhe për mosfunksionim të odave, prapë ministrisë i drejtohem. Edhe decentralizimi i Ligjit për shëndetësi dhe bartja e kompetencave në SSHKUK, ka hasur në vështirësi të mëdha. Bashkërisht, Ministria e Shëndetësisë dhe Kuvendi, duhet t'i mënjanojnë këto defekte në sistemin shëndetësor.

**Kryetarja** – Ne jemi Komision parlamentar shumë përgjegjës për çështjet shëndetësore. Jemi në procedurë të monitorimit të Ligjit të shëndetësisë dhe në fund do t'i japim rekomandimet tona.

**Fadil Beka** – Si komision, kemi pasur takim me kryetarët e odave dhe të gjithë e dimë se kemi një ligj të mirë, por para ligjit duhet të jemi të gjithë të barabartë. Nuk mund të kërkojmë vetëm nga Ministria e Shëndetësisë, se përse nuk i ka deleguar përgjegjësitë, përkundrazi ai që duhet t'i marrë përgjegjësitë, duhet të jetë më këmbëngulës. U diskutua edhe çështja e stafit. Unë mendoj se duhet të diskutohet dhe të gjendet mënyra e bartjes së kompetencave dhe e bashkëpunimit. Gjithashtu, edhe çështja e lokacionit të odave mund të diskutohet dhe ndoshta mund të gjendet mundësia e ndonjë lokacioni tjetër. Kërkesa kryesore e odave ka qenë financiare, sepse sipas tyre, duke u pavarësuar financiarisht, zgjidhen të gjitha problemet. Asnjë progres nuk e kanë cekur, nuk kanë cekur asnjëherë që janë pjesë e rilicencimit. Nëse disa oda kanë qenë më të suksesshme, atëherë nuk janë të gjitha pengesat vetëm te Ministria e Shëndetësisë. Realisht, edhe mbikëqyrja duhet të ekzistojë për një kohë. Duhet të gjendet një mekanizëm për funksionalizim të odave. Po shihet se Oda e Mjekëve, qenka prapa nga odat tjera.

**Hatim Baxhaku** – Kam pyetur kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë se ku është problemi kryesor për mosfunksionim të odave, dhe përgjigjja ka qenë, problemi kryesor janë financat. Dëshirojnë të kenë financa të pavarura dhe të menaxhojnë me ato financa, pa pasur ndërhyrje nga Ministria e Shëndetësisë. Kërkesa e vetme dhe kryesore është vetëm te buxheti, sa është e drejtë kjo, nuk e di.

**Kryetarja** – Ankesa ka qenë që edhe kryetarët e odave, ende asnjëri, asnjëherë nuk janë paguar. Pra, nuk kanë marrë pagën që garantohet me ligj dhe nuk pajtohem që procedura duhet të shkojë përmes gjyqit.

**Imet Rrahmani** – Në nenin 7 të ligjit të rishikuar të buxhetit për vitin 2016, nenit 5 të ligjit bazik i shtohet paragrafi si vijon: te nënprogrami, odat e profesionistëve shëndetësorë, të gjitha të hyrat e arkëtuara për vitin 2016 nga ky nënprogram do të barten në xhirollogarinë e odave. Sipas ligjit, kam kompetencë të shkarkojë secilin kryetar të odës, por nuk kam dashur të përzihem. Pra, vetë Kuvendi i Odës së Mjekëve, të reflektojë. Edhe koncepti i dokumentit të Ligjit për shëndetësi ka kaluar në Qeveri dhe shpejt do ta hartojmë plotësim-ndryshimin e ligjit, e edhe Ligjin e sigurimeve do ta ndryshojmë. Nëse nuk bëjmë ndërhyrje të shpejta, qoftë edhe me ndryshime ligjore në funksionimin e sistemit shëndetësor, ky sistem do të dështojë. Duke dashur të ndodhë decentralizimi, ka ndodhur centralizimi në një organizatë, që është SSHKUK, ndërsa përgjegjësia kërkohet për të gjitha problemet, vetëm nga ministri i Shëndetësisë. Neve na janë lënë përgjegjësitë, vetëm aty ku situata është më e ndjeshme. Duhet të mendohet mirë se si do të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për shëndetësinë.

**Kryetarja** – Buxheti që grumbullojnë këto spitale nga të hyrat vetjake, nuk shfrytëzohet nga vetë spitalet, por kthehen në buxhetin e Kosovës.

**Imet Rrahmani** – Këto mjete vetjake, gjithmonë derdhen në buxhetin e Kosovës. Në këtë vit, me gjithë shkurtimet buxhetore që kanë ndodhur, kemi siguruar mjete për pagesën e specializantëve dhe për specialistët, për këtë vit. Pra, nëse bëhen kursime, mund të bëhet më shumë me këtë buxhet që kemi.

**Besa Baftiu** – Ne e pamë përmes mediave, që në hematologji pacientët thonë se edhe një paracetamol, duhet ta blejnë. Gjendja faktike është e rëndë, nuk dimë kujt t'i besojmë. SHSKUK është dënuar për shkelje në tenderin për pastrimin e spitalit dhe kjo është shqetësuese. Ju jeni organi më i lartë mbikëqyrës dhe duhet të kërkonit llogaridhënie nga shkelësit e ligjit.

**Imet Rrahmani** – Kemi kërkuar llogaridhënie, ndërsa edhe ne jemi të shqetësuar për të gjitha problemet. Mbulimi i të gjitha harxhimeve shëndetësore nga Buxheti i Kosovës, është problem. Të gjitha problemet duhet të eliminohen gradualisht.

**Kryetarja** – Tani kur do të hartohet projektbuxheti për shëndetësi, për vitin 2017, ne duhet të jemi pjesë e këtij debati dhe të ketë shpërndarje më të mirë. Përveç ilaçeve, duhet të ketë edhe kushte të mjekimit, sepse trajtimi i pacientëve jashtë komove po na kushton më shumë.

Si konkluzion nga ky takim, kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë, që deri në janar të vitit 2017, t'i bartë të gjitha kompetencat te odat, si parashihet me ligj, ndërsa ne do ta mbajmë takimin tjetër pasues lidhur me funksionalizimin e odave.

**Imet Rrahmani** – Jemi të gatshëm, që në baza mujore, t'ju informojmë rreth funksionalizimit të odave.

**Kryetarja** – Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe për pjesëmarrje!

#### **4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor**

**Kryetarja** – E keni marrë draft-planin e punës për sesionin vjeshtor, a pajtoheni me këtë plan apo keni ndonjë propozim të ri?

**Besa Baftiu** – Unë kam propozuar që të diskutojmë për funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë, gjithashtu të intensifikojmë vizitat në terren, e sidomos të kemi vizitë dhe takim me komisionin homolog të Shqipërisë. Gjithashtu, propozoj t'i vizitojmë edhe institucionet e mjekësisë primare.

**Kryetarja** – Kemi disa aktivitete të përfshira në planin e punës. Mendoj se shumica janë përfshirë, por ne mund, sipas nevojës, të shtojmë aktivitetet e Komisionit.

*Pas diskutimeve, Komisioni miratoi planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor.*

#### **5. Të ndryshme**

**Kryetarja** – Nënkryetari Fikrim Damka të na njoftojë për Projektligjin për shërbimin emergjent, që ka qenë në diskutim në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

**Fikrim Damka** – Projektligji është diskutuar shumë në Komision, por ka pasur kundërshtime nga disa deputetë. Pra, duhet diskutuar me grupet parlamentare, që në seancë të kalojë projektligji, sepse rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, do të dalë me implikime buxhetore.

**Kryetarja** – Ju falënderoj për kontributin. Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

**Flora BROVINA**